



INSTITUTI I POLITIKAVE MJEDISORE
INSTITUTE FOR ENVIRONMENTAL POLICY



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

Të rinjtë, energjia e rinovueshme dhe punësimi

Konferencë, 24 Shkurt 2015

Endri Haxhiraj, MSc

Zv. Drejtor

Instituti i Politikave Mjedisore





Shumë të rinjë kanë hequr dorë nga të gjeturit punë, - ILO, 2011

KRIMI

Papunësia është e lidhur me përjashtimin social, duke ndikuar në:


- sjelljet anti sociale (si krimi);
- trazirat sociale;
- braktisjen e edukimit apo trajnimit të tyre të mëtejshëm.



Këto sfida i paraprijnë një krize ekonomike dhe financiare.


Alternativa e punëve të gjelbra

- Krijimi i punëve të gjelbra (“green jobs”) është një mundësi për të adresuar sfidat me të cilat përballen sot gratë dhe të rinjtë.
- Numri i punëve të gjelbra momentalisht është gjithnjë e në rritje dhe do të jetë drejtuesi energjik i ekonomisë në vitet që do vijojnë.
- Faza tranzitore e ekonomisë me nivel të ulët karboni, do të kërkojë një investim të konsiderueshëm në teknologji të reja, pajisje HD e infrastrukturë, çka do të gjenerojë vende të reja pune si dhe mbajtjen dhe transformimin e vendeve ekzistuese në shumë sektorë të ekonomisë.
- Në mbarë botën, ku të dhënat janë të disponueshme, më shumë se 2.3 milion njerëz janë të punësuar në këtë sektor.



Energjia e rinovueshme dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillimi ekonomik i shoqërive moderne është mjaft i varur nga energjia. Energjia është me rëndësi jetike për zhvillimin e qëndrueshëm. Ajo është përdorur për të gjeneruar energji elektrike për një shumëllojshmëri nevojash, ndër të cilat janë nevojat e brendshme, nevojat e transportit, dhe nevojat industriale.

The background of the slide features a light blue gradient. In the center, there is a stylized illustration of several solar panels mounted on a structure, tilted towards the right. Behind the solar panels, a faint map of Europe is visible, rendered in a light blue color that blends with the background.

Shembull 1 - Grameen Shakti



Grameen Shakti



Ndoshta shëmbulli më i njohur i punës së gjelbër është iniciativa Grameen Shakti në Bangladesh.

Rreth 60% e popullsisë nuk kanë akses të energjisë elektrike dhe vetëm 12% e popullsisë së Bangladeshit kanë akses me energji elektrike përgjatë gjithë ditës.

Grameen Shakti me anë të mbështetjes së disa njësive të qeverisjes vendore, financoi në 1996 një asistencë teknike për instalimin e 100 000 paneleve diellore në komunitete të zonave rurale, duke krijuar mundësi punësimit dhe duke fuqizuar rolin e gruas dhe të rinjve në këto zona.

Grameen Shakti

Shakti i ka dhënë një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes dhe motivimit të komunitetit. Ai ka punësuar të rinjtë si teknikë dhe ka trajnuar familjarë në mënyrë që të shmangen incidentet gjatë funksionimit të sistemeve.

Shakti ka trajnuar mbi 5000 gra si teknike të paneleve diellore dhe si punonjëse të mirëmbajtjes.

Shumë hapësira të tjera pune janë krijuar në mënyrë indirekte duke qënë se panelet diellore kanë mundësuar sipërmarrjet lokale si kompani televizive, qendra për karikimin e celularëve nëpërmjet energjisë diellore dhe dyqane për riparime të materialeve elektronike.



Mekanizmat finanacues qeveri-bashki

- Qeveria vendore lobim tek qeveria qëndrore
- Grante për të rinjtë për punët e gjelbra
- Vlerësim sipas performancës
- Grante në mënyrë të rregullt
- Verifikim i shpenzimeve në nivel kombëtar
- Politika mbi koston e programit
- Punët e gjelbërta si biznes i rregullt lokal



Përfitimet e qeverive lokale nga punët e gjelbërta

- ruajtjen e investimeve publike në infrastrukturë dhe shpenzimeve në sektorët socialë (p.sh. arsimi, shëndetësia, të mirëqenies sociale);
- të sigurojë stimulime për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- investimin dhe prokurimin e produkteve ekologjikisht të preferueshme;
- të heqë subvencionet për industritë që ndotin ose përdorin burimet natyrore dhe financiare joefikase;
- investojnë në kërkime për zhvillimin dhe promovimin e energjive alternative
- investim në punësim-intensiv; dhe
- rigjallërimin e tokave të pa shfrytëzuara komunale për shërbime publike që promovojnë punët e gjelbra.



Zonat rurale



Vendet në zhvillim kanë potencial të madh për energjinë e rinovueshme, veçanërisht në zonat rurale.

Banimi rural është i shpërndarë shpesh në mënyrë jo të njëtrajtshme. Në të tilla raste, nuk është e ekonomike të përpiqesh për të lidhur këto xhepa rurale me rrjetin. Në të njëjtën kohë, këto komunitete kanë nevojë për energji elektrike.

Turizmi


Turizmi ofron mundësi të mira veçanërisht për rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme.

Nëse një rajon gëzon trafik turistik, atëherë mjedisi i rajonit duhet të ruhet, duke siguruar për rritjen e kërkesës për energji gjatë periudhave të pikut për shkak të fluksit të qëndrueshëm të vizitorëve.

Për më tepër, ka rritje në turizëm edhe në zonat e izoluara të tilla si në ishujt dhe në rajonet malore, ku dërgesat e karburantit dhe lidhjet e rrjetit janë të kushtueshme




Sfidat e të rinjve



1. Mungesa e informacionit/njohurive të potencialit të tregut për energjinë e rinovueshme, shërbimeve, projektet e suksesshme të riaplikueshme, partnerët e mundshëm financiarë dhe mjetet
2. Mungesa e aftësive teknike ose komerciale për :
 - menaxhimin financiar të bizneseve,
 - krijimin e planeve të biznesit për të tregtuar energjinë e ripërtëritshme dhe know-how.
3. Të mos paturit akses në teknologji

Sfidat e të rinjve



- Mungesa e kapacitetit institucional për nxitjen e energjisë së rinovueshme tek të rinjtë;
- Rreziku i përfshirë në kosto të lartë:

Institucionet vendore nuk mund të përballojnë adaptimin e tyre pa përkrahjen e duhur financiare nga organizata të tjera.

Bizneset nuk janë gjithmonë të gatshëm për të investuar në teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme për shkak të mungesës së garancisë që ajo do të bëhet komercialisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse.

- Mungesa e përfshirjes së të rinjve, mungesa e infrastrukturës për të mbështetur projektet e punësimit të të rinjve, dhe të rinjtë nuk kanë besimin dhe eksperiencën e nevojshme dhe gjithashtu nuk kanë mjedis të përshtatshëm

Zgjidhjet:



Masat që duhet të ndërmeren për një mjedis të përshtatshëm

- Shpërndarjen e informacionit mbi energjinë e rinovueshme
- Ofrimi i aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave për të rinjtë dhe çështje të tjera të tilla si krijimi i planeve të biznesit në tregun e energjisë së rinovueshme, si dhe qasjen në teknologjinë e gjelbër dhe knoë-hoë.
- Zgjidhje të reja si sistemet e mikro-kredive (bizneset sociale) që fokusohen tek rinjtë si përgjegjësit kryesorë për zbatimin e tyre.
- Përfshirja e të rinjve në iniciativa bazë komunitare, duke marrë parasysh faktorët e ndryshme kulturore, i jep vlerë të shtuar për zhvillimin e bazës. Fuqizimi i të rinjve i ndihmon të arrijnë një spektër më të gjerë të komuniteteve.

TË RINJTË DHE ENERGJIA

Përdorimi i energjisë së të rinjve për promovimin e energjisë së rinovueshme do të ketë një efekt të trefishtë:

- Ajo do të nxjerrë energji të re në realizimin e shumë prej qëllimeve të përcaktuara nga komuniteti global për ndryshimin e klimës.
- Ajo do të vërë të rinjtë në aktivitete prodhuese dhe afat-gjatë të ndërtimit të kombit, larg nga aktivitetet jo prodhuese.
- Ajo do të drejtojë të rinjtë në aktivitete që gjenerojnë të ardhura në këtë sektor.



Shembull: Spitali Bulape në Zaire

Spitali Bulape në Zaire u shërben 50.000 pacientëve në vit dhe është i varur tërësisht nga energjia diellore, që nga kondicionimi i ajrit deri tek pajisjet e rrezeve X.



Ne foto paneli i autoklavës


Shembull: Izraeli

- Që në vitin 1992, më shumë se gjysma e të gjitha familjeve (700.000) përdornin sistemet e energjisë diellore për ngrohjen e ujit sanitar. Përveç kësaj, ka 50.000 instalime të reja çdo vit.



Shembull: Kuzhinat diellore Indi

- Kuzhinat Diellore - Kuzhina diellore që aktualisht funksionon në komunën Auroville është projektuar për të siguruar ushqim për 1000 njerëz në ditë. Burimet informojnë se aktualisht ka vetëm rreth 3-5 kuzhina të tilla diellore në Azi.
- Kuzhina diellore përdor një vazo konkave gjigande (vazo diellore). Kjo strukturë alegorike ka diametër 50 metra me kapacitet prodhues prej 76 kë (në pik). Këto vazo diellore kanë një krah të koncentruar në qendër. Ky krah i përqendruar lëviz në varësi të sezonit sipas rrotullimit të diellit. Kështu, "pika e nxehtë" (pikë e cila do të japë rrezet e diellit maksimale) është e disponueshme çdo 5 minuta. Kjo energji ngrohëse e koncentruar është përdorur për të ngrohur një solucion likuid. Ky solucion nxehet e pastaj hyn në një konvertues të nxehtësisë ku nxehtësia e lëngjeve është transferuar në ujë dhe uji konvertohet në avull.



Referencat:

Green Jobs for women and Youth what Can Local Governments Do? Copyright © April 2013, United Nations
Development Programm